



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2791 prot.

Shkodër, më 25.09 2023

Vendim

Nr. 207 datë 25.09.2023

**PËR FINANCIMIN E BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES NË KONFERENCA
SHKENCORE TË STAFIT AKADEMIK
TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI".**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, shkronja "c", nenit 38, pika 1, shkronja "k" në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të USH-së, me propozim të Rektorit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 25.09.2023

VENDOSI:

1. Të shpërndahet shuma e parashikuar në buxhet te zëri "Botime dhe pjesëmarrje në konferenca" të pedagogëve të USH-së në mënyrë të barabartë mes njësive kryesore për çdo vit akademik.
 - a) Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e *fee-s* (tarifës) së konferencës/botime/pagesën e biletave të udhëtimit dhe hotelit.
 - b) Kjo shumë nuk mund të shpenzohet më shumë se në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime brenda Shqipërisë (vetëm në ato tek lista e revistave që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni,

Mali i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime në revista të BE-së dhe OECD-së. Përjashtohen nga ky detyrim vetëm pedagogët që kryejnë veprimtarinë e tyre kerkimore-shkencore në fushën e Albanologjisë.

- c) Njësitë kryesore që nuk e përdorin fondin për një vit kalendarik, në vitin pasardhës shuma e parashikuar të jetë 50% (pesëdhjetë përqind) më pak dhe në qoftëse kjo nuk përdoret edhe në vitin kalendarik vijues, atëherë në të tretin vit kalendarik të përjashtohet nga përfitimi i fondit. Pas vitit të përjashtimit nga përfitimi i fondit, njësia kryesore ka të njëjtat të drejta të parashikuar në pikën 1 të mësipërme.
- d) Pedagogët duhet të përpiqen të vendosin marrëdhënie bashkëpunimi me kolegë dhe Universitete homologe.
- e) Kriteret e përfitimit të fondit:
- Të jenë pedagogë me kohë të plotë.
 - Të jenë autorë të parë.
 - Të kenë informuar të paktën 2 (dy) muaj para organizimit të konferencës (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e *fee*-s dhe biletave me vlerë sa më të ulët).
 - Të jenë të pranishëm në konferenca.
 - Të paraqesin brenda 2 (dy) javëve pas pjesëmarrjes së tyre një relacion të shkurtër mbi aktivitetin e zhvilluar.
 - Të deklarojnë (si 'Mirënjohje') në botim ose tek prezantimi që financimi i tyre kryhet nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
 - Pedagogët në vitin e parë të punës përfitojnë 50% të financimit për botim ose pjesëmarrje.
 - Të mos jenë duke përfituar leje akademike.
 - Të mos jenë pedagogë që vazhdojnë studimet e doktoratës jashtë shtetit dhe nuk janë të angazhuar me kohë të plotë në USH.
 - Të kenë "Doktor i Shkencave" ose të jenë duke vazhduar studimet e doktoratës.
- f) Të tjera

- Në qoftë se një njësi kryesore nuk arrin të shpenzojë fondin për një vit kalendarik, por dëshiron ta shpenzojë atë vitin pasardhës, ka të drejtë të vërë në dijeni jo më vonë se data 30 tetor Rektorin dhe Administratorin.
2. Vendimi nr.143, dt.14.07.2022 “Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në Konferenca Shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” shfuqizohet.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zv/rektori, Administratori, Drejtorja e Financës dhe Realizimi të Buxhetit.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Rajmonda KËÇIRA

